



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë **29.04.2024 (e martë)** me fillim në ora **10:10**

Mbledhjen e dytë e kryesoi Kryesuesja znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vizitë në QMF në fshatin Opterushë;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja: Atëherë fillimisht përshëndetje për të gjithë. Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime aprovet pika e parë e rendit të ditës.

2. Vizitë në QMF në fshatin Opterushë;

Lirigzon Kastrati: Përshëndetje për të gjithë! Propozoj që në kuadër të vizitës të paraparë për sot, të shkojmë fillimisht në Brestoc dhe të vazhdojmë në Opterushë.


Kryesuesja: Faleminderit! Në rregull, pajtohem!

3. Të ndryshme;

Lirigzon Kastrati: Dëshiroj të flas rreth çështjes së pagesës së anëtarëve të komitetit dhe të marrim një përgjigje nga drejtoria përkatëse, sepse ende nuk jemi duke u paguar me rregull!

Kryesuesja: Faleminderit Lirigzon! Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen, për të vazhduar tutje me vizitat e parapara.

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi



Kryesuesja e mbledhjes;


Vlora Vuçiterna - Çmega